



VENDIM

Nr. 21 Datë 20.02.2012

PËR

**MIRATIMIN E APLIKIMIT TË OST SH.A PËR NDRYSHIMIN E
PLANIT TE INVESTIMEVE PER PERIUDHEN E TRETE
REGULLATORE 2012 – 2014**

Në mbështetje të neneve 9, 24, dhe 64 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.02.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Aplikimi i OST sh.a për ndryshimin e planit te investimeve për vitin 2012 -2014, nuk ka impakt ne tarifen e transmetimit te miratuar per OST Sh.a. per periudhen e trete Rregullatore 2012-2014 dhe përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Të miratojë aplikimin e shoqërisë OST sh.a për ndryshimin e Planit të Investimeve per Periudhën e Trete Rregullatore 2012-2014, sipas tabelës bashkelidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI